

Deklaratë mbi çështjet dypalëshe

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor - të mbledhura në Vjenë, në praninë e Austrisë, Kroacisë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Sllovenisë, Komisionit Evropian, si dhe EEAS (European Union External Action – Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian) - angazhohen në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura dypalëshe në frymën e fqinjësisë së mirë dhe përkushtimit të përbashkët në rrugën e Integritimit Evropian. Qeveritë bien dakord të mos bllokojnë ose inkurajojnë të tjerët në bllokimin e përparimit të fqinjëve në rrugëtimet e tyre drejt BE-së.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor angazhohen në zgjidhjen e çdo çështjeje të hapur përmes bisedimeve dypalëshe ose mjeteve të tjera të zgjidhjes paqësore të **mosmarrëveshjeve, duke përfshirë arbitrazhin ndërkombëtar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.**

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor do të raportojnë çdo vit në samitin e Ballkanit Perëndimor mbi progresin e bërë në lidhje me marrëdhëniet dhe çështjet e pazgjidhura dypalëshe. Raporti i parë do të përgatitet nga qeveritë për t'u paraqitur në samitin që do të zhvillohet në Francë në vitin 2016. Raportet vjetore vijuese do të paraqiten në samitet e ardhshme.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor ftojnë qeveritë e vendeve fqinjë anëtarë të BE-së për t'iu bashkuar këtij angazhimi të përbashkët.

Ministrat e Jashtëm:

..... **Republika e Shqipërisë**

..... **Bosnje Hercegovina**

..... **Kosovo***

..... **Republika e Maqedonisë**

..... **Mali i Zi**

..... **Republika e Turqisë**

Vjenë, më 27 gusht 2015